Banka Popullore e Repubikës së Maqedonisë së Veriut

# INTERES I THJESHTË DHE I PËRBËRË

Në tetor, muajin e kursimit, kthehemi shkurtimisht mbi interesin.

Interesi është një kthim i kursimeve. Gjatë vlerësimit të nivelit të edukimit financiar të popullatës, vlerësohet edhe njohja e koncepteve bazë të interesit.

## Definimi i interesit

Interesi është një shumë që banka i paguan depozituesit, si përqindje e mjeteve të investuara.

Ekzistojnë dy lloje të interesit: interesi i thjeshtë dhe i përbërë.

## Interes i thjeshtë

Interesi i thjeshtë llogaritet si përqindje e mjeteve fillestare të investuara dhe çdo vit interesi është i njejtë.

## Interes i përbërë

Interesi i përbërë llogaritet në atë mënyrë që çdo periudhë e llogaritjes së interesit, t'i shtohet interesi mjeteve të investuara fillestare, që do të thotë se çdo periudhë baza e llogaritjes së interesit është më e lartë. Ky koncept njihet edhe si "interes i interesit" ose kapitalizimi i interesit dhe jep nje rendiment më të lartë.

<u>Sipas Anketës për matjen e edukimit financiar në Maqedoninë e Veriut në vitin 2019, në pyetjen:*</u>

Kur investoni 1000 denarë në një llogari kursimi me normë interesi fikse vjetore (interes i thjeshtë) prej 2%, sa para do të keni në llogari në fund të vitit të parë?

Saktë janë përgjigjur 45% (përgjigja e saktë është: 1020 denarë).

Llogaritja e interesit të thjeshtl sipas vendeve




Përqindja e përgjigjeve të sakta tregon aftësinë e të anketuarve për të llogaritur interesin e thjeshtë të kursimeve.

→



Burimi: OECD (2020), Financial Literacy of Adults in South East Europe www.oecd.org/daf/fin/financial-education/Financial-Literacy-of-Adults-in-South-East-Europe.pdf

<u>Sipas Anketës për matjen e edukimit financiar në Maqedoninë e Veriut në vitin 2019, në pyetjen:*</u>

Kur investoni 1000 denarë në një llogari kursimi me interes 2%, sa para do të keni në llogari në fund të vitit të pestë, nëse interesi u shtohet mjeteve të investuara në fund të çdo viti?

Saktë janë përgjigjur 29% (përgjigja e saktë është: më shumë se 1100 denarë).

Llogaritja e interesit të përbërë




Sipas përgjigjeve të sakta (29% e të anketuarve në vendin tonë), koncepti i normës së interesit të përbërë është më pak i kuptueshëm për popullatën.

Për të shpjeguar konceptin e interesit të përbërë, tabela tregon llogaritjen sipas pyetjes nga Anketa:

Logaritja e interesit të përbërë

| periudha vjetore | shuma fillestare | norma e interesit | shuma e interesit | shuma totale e interesit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 1000 | 0 | 20 | 1020 |
| 2 | 1020 | 0 | 20 | 1040 |
| 3 | 1040 | 0 | 21 | 1061 |
| 4 | 1061 | 0 | 21 | 1082 |
| 5 | 1082 | 0 | 22 | 1104 |

Banka Popullore vazhdon me aktivitetet për edukim financiar të popullatës!